



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 30

12 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 28/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të ndryshuar.....	1217
Ligj nr. 29/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar.....	1218
Ligj nr. 30/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar.....	1221
Ligj nr. 31/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.....	1222
Ligj nr. 32/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.....	1224
Ligj nr. 33/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, të ndryshuar.....	1225
Ligj nr. 34/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”, të ndryshuar.....	1227
Ligj nr. 35/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9103, datë 10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”.....	1228
Ligj nr. 36/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar	1230
Ligj nr. 37/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.....	1232

Ligj nr. 38/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar.....	1234
Ligj nr. 39/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.....	1235
Ligj nr. 40/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”.....	1237
Ligj nr. 41/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar.....	1238
Ligj nr. 42/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, të ndryshuar.....	1240
Ligj nr. 43/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”	1242
Ligj nr. 44/2013 datë 14.2.2013	Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.....	1243
Ligj nr. 45/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, të ndryshuar.....	1244
Ligj nr. 46/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar.....	1248
Ligj nr. 47/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar.....	1249
Ligj nr. 48/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”.....	1250
Ligj nr. 49/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.....	1251
Ligj nr. 50/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9928, datë 9.6.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1253
Ligj nr. 51/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.....	1255
Ligj nr. 52/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”.....	1256

LIGJ
Nr. 28/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8897, DATË 16.5.2002 “PËR
MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Gjoha si dënim kryesor vendoset, shqyrtohet dhe vendoset përfundimisht nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit. Inspektorati, krahas gjobës, vendos dënime plotësuese dhe merr masat urgjente të nevojshme në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Masa e pezullimit të veprimtarisë, sekuestrimit, mbylljes së përhershme të veprimtarisë apo ndërprerjes së veprimtarisë, të parashikuara në këtë nen, janë dënime plotësuese.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, që burojnë nga ky ligj, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

5. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit për marrjen e masave urgjente, dënimin me gjobë dhe vendosjes e dënimeve plotësuese, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7987, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 29/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 64/2012, DATË 31.5.2012 “PËR
PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin” të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit” dhe emërtimi “inspektorët për peshkimin” zëvendësohet me emërtimin “inspektorët e inspektoratit që mbulon fushën e inspektimit”.

Neni 2

Në nenin 19, shkronja “i” e pikës 3 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 64, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Organet shtetërore, të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi, kanë të drejtë të inspektojnë infrastrukturën e transferuar, sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 4

Neni 79 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 79

**Anijet e peshkimit që nuk janë subjekt i kërkesave
të librit të anijeve të peshkimit**

Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit dhe QNOD-ja monitorojnë aktivitetet e peshkimit të anijeve që nuk janë subjekt i kërkesave për plotësimin e librit të anijeve të peshkimit, si rregull, në bazë të programit të inspektimit.”.

Neni 5

Në nenin 108, fjalia e parë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Në rastin kur mjeti i humbur nuk është gjetur, atëherë zotëruesi i anijes lajmëron inspektorin përkatës që mbulon fushën e peshkimit për:”.

Neni 6

Neni 121 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 121

Autoriteti i inspektimit të peshkimit

1. Autoriteti i inspektimit të peshkimit është inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.
2. Inspektorët kryejnë inspektimin në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.”.

Neni 7

Pikat 3 dhe 5 të nenit 122 dhe neni 124 shfuqizohen.

Neni 8

Neni 125 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 125

1. Kryeinspektori i inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit ose personi i autorizuar prej tij caktojnë specialistë me detyrën vëzhgues ose marrës i mostrave në peshkim, i cili:

a) duhet të pajiset me një dokument identifikimi të lëshuar nga kryeinspektori, i detyrueshëm për ta mbajtur me vete në çdo kohë gjatë kryerjes së detyrës. Këtë dokument vëzhguesi ka për detyrë t’ua tregojë pronarëve të subjekteve ose kapitenëve të anijeve të peshkimit, kur kërkojnë të hipin në një anije peshkimi që ndodhet në ujërat shqiptare ose kur kërkojnë të kryejnë intervista në lidhje me aktivitetin e peshkimit në territorin shqiptar;

b) gjithmonë duhet ta kryejë veprimtarinë e tij në prani të inspektorit të inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit dhe në përputhje me ligjin për inspektimin;

c) i caktuar, sipas këtij ligji, gëzon të njëjtën mbrojtje si inspektori për peshkimin.

2. Vëzhguesi ka për detyrë:

a) të vëzhgojë zënien, trajtimin e përpunimin e burimeve ujore dhe veprimtaritë e lidhura me to, si dhe të regjistrojë të dhënat në lidhje me këto veprimtari;

b) të grumbullojë dhe të regjistrojë informacionin biologjik e informacionet e tjera të lidhura me aktivitetin që rregullohet nga ky ligj;

c) të grumbullojë mostra të burimeve ujore të peshkuara;

ç) të raportojë pranë inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit për të gjitha vëzhgimet dhe informacionin e marrë sipas këtij neni;

d) të kryejë edhe aktivitete të tjera, të cilat përcaktohen nga inspektorati që mbulon fushën e peshkimit;

dh) në rast se vëzhguesi vepron në zbatim të rregullave të një marrëveshjeje ndërkombëtare, të ndërmarrë ato aktivitete, për të cilat është rënë dakord ndërmjet inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit dhe autoritetit përkatës të këtij autoriteti, të shprehur në marrëveshje, por që nuk janë në kundërshtim me shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. Inspektorati që mbulon fushën e inspektimit i kërkon personit mbajtës të lejes së peshkimit profesional ose kapitenit të një vendi tjetër:

a) të pranojë një vëzhgues peshkimi në bordin e anijes së peshkimit;

b) të pranojë vëzhguesit e peshkimit në çdo pronë dhe mjediset e përdorura për shfrytëzimin e burimeve ujore detare;

c) të lejojë vëzhguesit e peshkimit, të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, të kenë akses në të gjitha pjesët e tokës, anijet e peshkimit dhe lokaleve, si dhe tek të dhënat, dokumentet për burimet ujore detare që gjenden atje;



ç) të sigurojë akomodim të arsyeshëm për vëzhguesit e peshkimit, të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike;

d) të lejojë vëzhguesit e peshkimit, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike të përdorin të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij ose të saj.

4. Një marrës mostrash i peshkimit është i autorizuar të mbledhë informacion të tillë apo statistika, siç kërkohet nga inspektorati që mbulon fushën e peshkimit dhe mund:

a) të hipë në bord të çdo anije peshkimi, me qëllim mbledhjen e informacionit të peshkimit;

b) të intervistojë dhe të marrë informacione të tilla nga pronarët, kapitenët dhe peshkatarët e anijeve të peshkimit shqiptare të regjistruara.

5. Marrësit e mostrave të peshkimit u nënshtrohen kërkesave të konfidencialitetit, sipas nenit 96 të këtij ligji.”.

Neni 9

Neni 126 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 126

Masat që merren për të garantuar zbatimin e legjislacionit

Për të garantuar zbatimin e legjislacionit, vendoset gjobë si dënim kryesor, e cila shqyrtohet dhe vendoset përfundimisht nga inspektorati që mbulon fushën e peshkimit. Inspektorati, krahas gjobës, vendos dënime plotësuese dhe merr masat urgjente të nevojshme në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.”.

Neni 10

Neni 128 ndryshohet si më poshtë:

1. Shkronja “b” e këtij neni shfuqizohet.

2. Shkronja “c” e këtij neni ndryshohet si më poshtë:

“c) Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 11

Në nenin 130, fjalët “sanksion”, “sanksionimi” dhe “sanksionuar” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “dënim”, “dënimi” dhe “dënuar”.

Neni 12

Neni 131 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 131

Ankimi

Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit për marrjen e masave urgjente, dënimin me gjobë dhe vendosjes e dënimeve plotësuese, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7988, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 30/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8905, DATË 6.6.2002 “PËR
MBROJTJEN MJEDISIT DETAR NGA NDOTJA DHE DËMTIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Inspektimi, në zbatim të këtij ligji, bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 3

Në nenin 19, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organi që vendos gjobën, bën shqyrtimin e saj dhe merr vendimin përfundimtar, sipas këtij neni, është inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit.”

Neni 4

Pas nenit 19 shtohen nenet 19/1 dhe 19/2 me këtë përmbajtje:



“Neni 19/1

Klasifikimi i dënimeve dhe masat urgjente

1. Dënimet administrative të dhëna në zbatim të këtij ligji klasifikohen si më poshtë:
 - a) Gjoha është dënim kryesor.
 - b) Masa e pezullimit të përkohshëm ose e ndërprerjes së veprimtarisë, ndalimi i menjëhershëm i veprimtarisë dhe sekuestrimi i mjeteve dhe pajisjeve janë dënime plotësuese.
2. Nëse është e nevojshme, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, merr masa urgjente sipas ligjit për inspektimin.

Neni 19/2

Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit për marrjen e masave urgjente, dënimin me gjobë dhe vendosjen e dënimeve plotësuese bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve të inspektoratit bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7989, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 31/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 431, DATË 9.6.2011 “PËR
MBROJTJEN E MJEDISIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 62 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, në vijim “Inspektorati”. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ka këto funksione:”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Funksionet e inspektimit ushtrohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit për inspektimin.”.

Neni 2

Në nenin 66, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Masa administrative e njoftimit për pezullimin e veprimtarisë, sipas këtij neni, është masë urgjente dhe mund të jepet krahas masave të tjera të nevojshme, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Në nenin 69, pikat 2 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

“2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 69 të këtij ligji, e ka inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit. Krahas dënimit kryesor me gjobë, inspektori ka të drejtë të vendosë edhe dënimin plotësues të sekuestrimit të pajisjes, me të cilën, sipas tij, është kryer kundërvajtja e parashikuar në këtë ligj.

6. Inspektori shqyrton, merr vendimin përfundimtar dhe bën dokumentimin e tij në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7990, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 32/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 463, DATË 22.9.2011 “PËR
MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 56, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit inspekton instalimet, mbi të cilat zbatohet ky ligj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 62, pas pikës 62 shtohet pika 63 me këtë përmbajtje:

“63. Gjoha, në zbatim të këtij neni, vendoset nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me ligjin për inspektimin dhe është dënim kryesor.”.

Neni 3

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 63

Masat në rastet e shkeljes së lejes së mjedisit

1. Autoritetet, në rastet e shkeljes së lejes së mjedisit, marrin masat e parashikuara në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

2. Kur shkelja e këtij ligji ka të bëjë me përdorimin e një automjeti, ky i fundit konfiskohet nga autoritetet përkatëse, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Licenca e transportit të mbetjeve, e tregtarit dhe agentit të mbetjeve revokohet nga ministri, me propozimin e inspektorit, kur shkelen kushtet dhe rregullat e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit për ushtrimin e veprimtarisë dhe, për këtë, ministri njofton Qendrën Kombëtare të Licencimit.

4. Inspektori, sipas nevojave të rastit, merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Pas nenit 63 shtohet neni 63/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 63/1

Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ndaj vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim sipas ligjit për inspektimin.
2. Ndaj vendimeve të organeve të tjera, të marra në zbatim të këtij ligji, bëhet ankim sipas dispozitave në fuqi.
3. Kundërvajtësi paguan gjobën administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, me përjashtim të rastit kur vendimi për gjobën është pezulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Kur gjoba administrative nuk është paguar brenda datës së caktuar në pikën 3 të këtij neni, autoriteti përkatës ka të drejtë të pezullojë apo të revokojë lejen e mjedisit, licencën apo autorizimin derisa gjoba të paguhet.
5. Të ardhurat e grumbulluara nga gjobat dhe interesat derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrorë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekreten nr. 7991, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 33/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9108, DATË 17.7.2003 “PËR
SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:



1. Emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

2. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) Merr masa urgjente në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.”.

3. Shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit” dhe emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) Merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Klasifikimi i dënimeve

1. Në zbatim të neneve 23, 24 dhe 25 të këtij ligji dhe ligjit për inspektimin, inspektorët e inspektorateve përkatëse vendosin një nga dënimet kryesore si më poshtë:

a) gjoba;

b) urdhërimi për ndreqjen e parregullsive.

2. Krahas dënimit kryesor, inspektorët në zbatim të nenit 26 të këtij ligji, vendosin edhe një ose disa nga dënimet plotësuese si më poshtë:

a) mbylljen e veprimtarisë;

b) heqjen e licencës;

c) sekuestrimin e produkteve të rrezikshme.”.

Neni 4

Në nenin 26, pikat 8, 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

Neni 5

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

1. Gjoba dhe dënimet plotësuese vendosen në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin nga inspektorati, i cili fillon i pari procesin e inspektimit.

2. Kundër vendimit të inspektorit ose inspektorëve, mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Gjjobat e vëna derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe paguhen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Për çdo ditë vonesë, pas plotësimit të këtij afati, kundërvajtësi detyrohet të paguajë, përveç gjobës, një shumë të barabartë me 2 për qind të gjobës për një afat deri në 30 ditë. Me kalimin e këtij afati zbatohen dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 6
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7992, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 34/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9115, DATË 24.7.2003
“PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit” dhe emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”.

Neni 2

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Dënimet dhe masat urgjente

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit jep dënim kryesor me gjobë si më poshtë:

- a) Për shkronjat “e”, “ë”, “f” dhe “g” nga 100 000 deri në 300 000 lekë;
- b) Për shkronjat “a”, “b”, “e” dhe “dh” nga 300 000 deri në 500 000 lekë;
- c) Për shkronjat “ç” dhe “d” nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.



2. Krahas dënimit me gjobë, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit mund të vendosë edhe dënimin plotësues të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit të shkaktuar.

3. Shqyrtimi dhe marrja përfundimtare e vendimit bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Sipas nevojave të rastit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin, inspektorati merr masa urgjente.”.

Neni 3

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25
Ankimi

Kundër vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7993, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 35/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9103, DATË 10.7.2003
“PËR MBROJTJEN E LIQENEVE NDËRKUFITARE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9103, datë 10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi:

- a) “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”;
- b) “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”;
- c) “Policia e Ndërtimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Përgjegjës”.

Neni 2

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

1. Për kundërvajtjet administrative të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, jep dënim kryesor me gjobë si më poshtë:
 - a) Për shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” nga 100 000 deri në 300 000 lekë;
 - b) Për shkronjat “b”, “c” dhe “d” nga 300 000 deri në 500 000 lekë;
 - c) Për shkronjat “a” dhe “ç” nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.
2. Krahas dënimit me gjobë, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit mund të vendosë edhe dënimin plotësues të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit të shkaktuar.
3. Shqyrtimi i vendimit bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Sipas nevojave të rastit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin, inspektorati merr masa urgjente.”.

Neni 3

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Ankimi

Kundër vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7994, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 36/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9385, DATË 4.5.2005 “PËR SHËRBIMIN PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Funkzioni kontrollues ushtrohet nga Policia Pyjore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në shkronjën “c” të pikës 1 fjalët “me degët e saj rajonale” hiqen.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Policia pyjore është pjesë organike e inspektoratit shtetëror të ministrisë që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, pyjeve dhe ujërave. Strukturat dhe organikat menaxhuese të shërbimit pyjor miratohen me urdhër të Kryeministrit dhe me propozimin e ministrit.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit shtetëror të ministrisë që mbulon fushën e mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujërave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Në nenin 12, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Policia Pyjore është organ i specializuar i shërbimit pyjor, me funksione kontrolluese. Struktura e Policisë Pyjore, gjatë kryerjes së shërbimit, përfiton status të njëjtë me atë të Policisë së Shtetit.”.

Neni 4

Në nenin 37 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Inspektorët e Policisë Pyjore, kur vërejnë shkeljen e këtyre dispozitave, mbajnë procesverbal, në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Punonjësit e tjerë të shërbimit pyjor, punonjësit e pushtetit vendor që mbulojnë pyjet dhe pronarët privatë, në rastet kur konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Policinë Pyjore për të kryer procedurat e nevojshme.”.

Neni 5

Në nenin 38 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “r” shtohet shkronja “rr” me këtë përmbajtje:
“rr) mosnjoftimi i inspektoratit për shkeljet e konstatuara nga subjektet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 37 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.”.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“3. Sipas nevojave të rastit, krahas dënimit kryesor me gjobë, merren edhe masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 6

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Vendimi për kundërvajtjet administrative dhe ankimi

1. Inspektori i Policisë Pyjore merr vendimin për marrjen e masave urgjente, caktimin e dënimit kryesor dhe dënimeve plotësuese, në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Në zbatim të këtij ligji dënime plotësuese janë:
 - a) masa e sekuestros, sipas nenit 39 të këtij ligji;
 - b) mbyllja e përhershme e veprimtarive dhe çmontimi i instalimeve, sipas nenit 40/3 të këtij ligji.
3. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të këtij neni mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 7

Neni 40/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40/1

1. Për çdo rast të kryerjes së kundërvajtjes administrative apo veprës penale në pyje, nga inspektori vlerësohet edhe dëmi që është shkaktuar.
2. Struktura menaxhuese e sipërfaqeve pyjore, pronë shtetërore, ose njësia përkatëse e qeverisjes vendore që ka në pronësi sipërfaqen pyjore, në të cilën ka ndodhur kundërvajtja, janë të detyruara të kërkojnë, në çdo rast, shpërblimin e dëmit nga kundërvajtësi. Këtë të drejtë e gëzon edhe pronari privat për sipërfaqen në pronësi të tij.
3. Në zbatim të këtij neni, Policia Pyjore njofton subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për dënimin e konstatuar dhe u përcjell atyre të gjithë praktikën përkatëse.
4. Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlerës së dënimit të shkaktuar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.



Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7995, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 37/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9587, DATË 20.7.2006 “PËR
MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 49 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”, emërtimi “Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së bimëve” dhe emërtimi “Inspektorati Zooveteriner” zëvendësohet me emërtimin “Shërbimi i Zooteknisë”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për ruajtjen e biodiversitetit dhe të përbërësve të tij, në zbatimin e kërkesave të këtij ligji, ushtrojnë kontroll inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, Policia e Shtetit, Policia Pyjore, inspektorati që mbulon fushën e peshkimit, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së bimëve, Shërbimi i Zooteknisë dhe inspektoratet e tjera.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Për ruajtjen e biodiversitetit dhe të përbërësve të tij, në zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, inspektorët përkatës marrin masa urgjente sipas nevojave të rastit.”.

Neni 3

Në nenin 54, pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, jep dënimin kryesor me gjobë:

a) Për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “ë” dhe “j”, nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) Për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “ç”, “e”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

4. Krahas dënimit me gjobë, mund të vendosen edhe dënimet plotësuese të sekuestrimit të mjeteve që shkaktojnë dëmtimin, ose heqja e lejes mjedisore, si dhe masa e pezullimit të pjesshëm ose të plotë të veprimtarisë, duke përcaktuar edhe masat për rehabilitimin e gjendjes, sipas nenit 49 të këtij ligji. Në çdo rast kundërshtimi për zbatimin e këtyre masave, inspektorati që mbulon fushën e mjedisit bashkëpunon me Policinë e Shtetit.

5. Shkeljet e parashikuara në krerët IV, V dhe VI të këtij ligji, përveç gjobave dhe dënimeve plotësuese të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, në të gjitha rastet, shoqërohen edhe me dënimin plotësues të konfiskimit të materialit biologjik dhe të mjeteve, me të cilat është kryer veprimi i paligjshëm.”.

Neni 4

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 55 Ankimi

Kundër vendimit që cakton sanksionet administrative të parashikuara në këtë ligj mund të bëhet ankimi në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5 Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrijë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7996, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 38/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9693, DATË 19.3.2007 “PËR FONDIN KULLOSOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30
Dokumentimi

1. Ushtrimi i kontrollit dhe dokumentimi i tij bëhen nga organet e kontrollit, të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Të drejtën e vendosjes së gjobës, si dënim administrativ kryesor, të parashikuar në nenin 34 të këtij ligji, e kanë organet e kontrollit, të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji.”.

Neni 2

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31
Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të strukturës përkatëse për marrjen e masave urgjente, vendosjen e dënimit kryesor dhe dënimeve plotësuese bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Neni 32 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Sekuestrimi dhe masat urgjente

1. Mjetet dhe pajisjet, që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes dhe çdo përfitim pasuror i siguruar prej saj, sekuestrohen dhe kalojnë në llogari të administruesit të kullotës.
2. Masa e sekuestrimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është dënim plotësues.
3. Struktura përgjegjëse, në varësi të rastit, merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7997, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 39/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9774, DATË 12.7.2007 “PËR VLERËSIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Emërtimi “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”; emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”; emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Punës” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e punës” dhe emërtimi “Inspektorati i Kontrollit të Automjeteve” zëvendësohet me emërtimin “Struktura përgjegjëse për kontrollin e automjeteve”.



2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni ushtrojnë kontroll për zhurmën, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera në fuqi.”.

Neni 2

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Vendimi i kontrollit

1. Pas kryerjes së kontrollit, vendimi merret në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektori ose zyrtari i ngarkuar me këtë funksion i strukturës përgjegjëse të pushtetit vendor që bën kontrollin. Në rast të konstatimit të shkeljeve, inspektori ose zyrtari cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, sipas rastit, vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë.

2. Rezultatet dhe vendimi i kontrollit u njoftohen subjektit të kontrolluar dhe organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet veprimtaria e kontrolluar. Një përmbledhje e vendimit të kontrollit vihet në dispozicion të publikut për 1 muaj, duke u depozituar në organin e qeverisjes vendore përkatëse.

3. Sipas nevojave të rastit, inspektori ose struktura përgjegjëse e pushtetit vendor, marrin masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Në nenin 32 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga organet e kontrollit, të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, me dënim kryesor me gjobë si më poshtë:”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Krahas dënimit me gjobë, në varësi të dëmit që shkakton zhurma, vendoset edhe dënimi plotësues i mbylljes së përkohshme, derisa subjekti të marrë masat e nevojshme për eliminimin e saj, ose mbyllja e përhershme e burimit të zhurmës.”.

Neni 4

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Ankimi

Ndaj vendimit të inspektorit ose të zyrtarit të strukturës përgjegjëse të pushtetit vendor mund të bëhet ankimi në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7998, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 40/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9867, DATË 31.1.2008 “PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR TË
LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

Neni 2

Në nenin 32 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Kur shkeljet e përmendura më poshtë nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë:”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Krahas dënimit kryesor me gjobë, mund të vendosen edhe dënimet plotësuese të heqjes së lejes ose sekuestrimit të parashikuar në nenin 34 të këtij ligji.”.

Neni 3

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35
Dokumentimi

1. Procesi i inspektimit dhe dënimit të shkeljeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.



2. Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Policisë Pyjore, inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.”.

Neni 4

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36
Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37
Pagimi i gjobës

Gjoha paguhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të formës së prerë. Pas kalimit të këtij afati, personi paguan një kamatë në masën 2 për qind të vlerës së gjobës për çdo ditë për një afat deri në 30 ditë. Me kalimin e këtij afati zbatohen dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 6
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrijë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7999, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 41/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 006, DATË 23.10.2008 “PËR
MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 40 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

2. Në pikën 4, fjalët “inspektorët veterinarë e fitosanitarë” zëvendësohen me fjalët “veterineri zyrtar dhe inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Veprimtaria kontrolluese, sipas këtij neni, ushtrohet në përputhje me këtë ligj, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera në fuqi.”.

Neni 2

Në nenin 42, emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

Neni 3

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

Masa të tjera

1. Organet e kontrollit, në bazë të përmasave dhe pasojave të kundërvajtjes administrative apo të veprës penale, veç gjobës, si dënim kryesor, vendosin edhe dënimin plotësues të pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë ose mbylljes së përhershme të saj.

2. Në çdo rast, kur vërtetohet një kundërvajtje administrative apo një veprë penale, organet e kontrollit vendosin edhe dënimin plotësues të konfiskimit ose sekuestrimit të individëve të kapur, të mbajtur në robëri, si dhe mjetet e pajisjet, me të cilat është kryer kundërvajtja apo vepra penale.”.

Neni 4

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 45

Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.



Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8000, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 42/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 120, DATË 23.4.2009 “PËR
MBROJTJEN E FONDIT TË BIMËVE MJEKËSORE, ETEROVAJORE E TANIFERE
NATYRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 31 emërtimi “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 40, në paragrafin e parë, para fjalëve “me gjobë” shtohen fjalët “me dënim kryesor”.

Neni 3

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

Dokumentimi dhe vendosja e masës administrative

1. Procesi i inspektimit, konstatimit të shkeljes, pasqyrimit të saj dhe dënimit bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në këtë ligj, e kanë inspektorët e Policisë Pyjore, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe inspektorët e organeve vendore për sipërfaqet pyjore e kullosore që ato kanë në pronësi apo në përdorim.

3. Në rastet kur bëhen kontrole nga më shumë se një inspektorat apo edhe nga struktura përgjegjëse e pushtetit vendor, masa administrative, në zbatim të këtij ligji, jepet nga inspektorati, i cili

fillon i pari procesin e inspektimit. Në qoftë se procesi fillon njëkohësisht, në të njëjtën datë, nga më shumë se një inspektorat, apo edhe nga inspektorët e organeve vendore, procesi i vënies së gjobës realizohet nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit.”.

Neni 4

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44 **Ankimi**

Ndaj vendimit që vendos masën administrative mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 45 **Pagimi i gjobës**

1. Gjoba paguhet brenda 30 ditëve dhe, pas kalimit të këtij afati, i gjobituri paguan edhe kamatë, në masën 2 për qind të vlerës së gjobës, për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë.

2. Në rast se gjoba dhe kamata nuk paguhen brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, atëherë zbatohet legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 6

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8001, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 43/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 253, DATË 11.3.2010 “PËR GJUETINË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 59, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
“Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë si më poshtë:”.

Neni 2

Neni 60 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 60
Dokumentimi

1. Inspektimi dhe dënimi i shkeljeve bëhen nga inspektori i Policisë Pyjore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
2. Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, leja e gjuetisë i merret, ndërsa armët e mjetet e gjahut sekuestrohen me procesverbal dhe i dorëzohen me procesverbal Policisë së Shtetit. Arma e sekuestruar i kthehet gjuetarit sezonin e ardhshëm pasi të ketë paguar gjobën përkatëse.
3. Masat e konfiskimit të gjahut të vrarë, marrjes së lejes së gjuetisë dhe sekuestrimi i armës janë dënime plotësuese, që mund të jepen krahas dënimit kryesor me gjobë.”.

Neni 3

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61
Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62
Pagimi i gjobës

1. Gjobat për kundërvajtjet administrative, sipas këtij ligji, paguhen brenda 30 ditëve. Personit nuk i kthehen leja dhe arma e gjuetisë pa paguar më parë gjobën.
2. Të ardhurat e grumbulluara nga pagesa e gjobave derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 5
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8002, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 44/2013**

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011 “PËR LEJET E MJEDISIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 29 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4, 6, 7 dhe 12 ndryshohen si më poshtë:
 - “3. Pavarësisht nga dënimi kryesor me gjobë, të parashikuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vetë ose me propozimin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës, mund t’i propozojë ministrit pezullimin apo revokimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj, masë e cila është dënim plotësues.
 4. Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës shqyrton dhe merr përfundimisht vendimin në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
 6. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, mund të bëjë ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.
 7. Gjoha paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike.



12. Çdo masë administrative e marrë në zbatim të këtij ligji ekzekutohet në përputhje me legjislationin në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin 8003, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 45/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 7643, DATË 2.12.1992 “PËR SHËNDETIN PUBLIK DHE INSPEKTORATIN SANITAR SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit bëhet “Për inspektimin sanitar”.

Neni 2

1. Kudo në ligj, emërtimi “Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Shëndetësisë”; emërtimi “Instituti Kërkimor i Higjienës dhe Epidemiologjisë” zëvendësohet me emërtimin “Instituti i Shëndetit Publik” dhe emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”.

Neni 3

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Inspektimi sanitar është veprimtaria që kontrollon përmbushjen e rregullave higjieno-sanitare, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga faktorët e dëmshëm për shëndetin dhe pasojat që rrjedhin prej tyre.”.

Neni 4

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Inspektimi sanitar

Inspektimi sanitar për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.”.

Neni 5

Në nenin 7, emërtimi “Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 6

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Ndërmarrjet, institucionet shtetërore e private dhe personat e tjerë, fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve të ndryshme duhet të bëjnë vetëdeklarimin për plotësimin e kushteve higjieno-shëndetësore në strukturën vendore të shëndetit publik.

Struktura vendore e shëndetit publik, pasi bën ekspertimin higjieno-shëndetësor paraprak, jep akt-miratimin për:

- miratimin e sheshit të ndërtimit;
- miratimin e projektit ndërtimor, teknologjik, rindërtimit, rikonstruksionit;
- vënien në shfrytëzim të objektit.

Kur vërehen shkeljet e sipërpërmendura, inspektorati që mbulon fushën e shëndetit ndalon me vendim fillimin ose vazhdimin e punimeve, duke kërkuar plotësimin e mangësive. Masa e ndalimit të fillimit ose vazhdimit të punimeve, në varësi të rrethanave dhe përcaktimit që bën inspektori përkatës, është dënim plotësues ose masë urgjente. Zbatimi i vendimit sigurohet, kur shihet e nevojshme me ndërhyrjen e organeve të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.”.

Neni 7

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Strukturat vendore të shëndetit publik kanë për detyrë të pajisin me librezë shëndetësore të gjithë personat që punojnë në objektet e prodhimit, të ruajtjes, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, në ujësjellës, në institucione parashkollore, shkollore e shëndetësore dhe në objektet e shërbimit publik, ku mund të lehtësohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse.



Të drejtën e kontrollit për pajisjen me librezë shëndetësore e ka inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe çdo inspektorat shtetëror tjetër që i jepet kjo kompetencë nga një ligj tjetër i posaçëm.

Lista e profesioneve dhe kategoritë e punonjësve që pajisjen me librezë shëndetësore përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.”.

Neni 8

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Inspektorët e inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit, për kryerjen e detyrave të ngarkuara nga ky ligj, ushtrojnë kontroll në të gjitha objektet e përcaktuara në nenin 10.”.

Neni 9

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Për kundërvajtjet administrative sanitare, të parashikuara nga neni 26 i këtij ligji, inspektorati që mbulon fushën e shëndetit vendos dënimin kryesor me gjobë si më poshtë:

- Për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 2, 3, 6, 7 dhe 14, masa e gjobës është 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

- Për shkeljet e parashikuara në pikat 4, 5 e 8, masa e gjobës është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

- Për shkeljet e parashikuara në pikat 10, 11, 12, 13 e 15, masa e gjobës është 200 000 (dyqind mijë) lekë;

- Për shkeljet e parashikuara në pikat 9, 16, masa e gjobës është 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

Për personat e pajisur me librezë shëndetësore, krahas dënimit me gjobë, si dënim plotësues mund të vendoset edhe heqja e librezës shëndetësore nga 3-12 muaj.

Masat, që merren nga inspektorati, sipas neneve 18 dhe 19, në varësi të rrethanave të rastit, mund të vlerësohen nga vetë inspektorati si masa urgjente ose dënime plotësuese. Ndërsa masa e pezullimit ose e mbylljes së përkohshme a të përhershme të objektit apo veprimtarisë, sipas nenit 30 të këtij ligji, janë dënime plotësuese. Kur shkeljet administrative sanitare janë me pasoja të rënda për shëndetin e njerëzve, çështja denoncohet për ndjekje penale në organet e prokurorisë.”.

Neni 10

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Marrja e masave urgjente nga shërbimi epidemiologjik

Në rastet kur organet e kontrollit të shërbimit epidemiologjik, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, konstatojnë shkaqe, të cilat vënë në rrezik jetën, shëndetin apo përbëjnë potencial për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, marrin të gjitha masat urgjente të nevojshme dhe njoftojnë menjëherë inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.

Inspektorët e inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit kërkojnë mbështetjen e strukturave të shërbimit epidemiologjik sa herë që vlerësohet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tyre në lidhje me parandalimin, kufizimin dhe eliminimin e pasojave të dëmshme për shëndetin.”.

Neni 11

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Ndaj vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 12

Në nenin 31, paragrafët 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Ankimi ndaj kësaj mase bëhet në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.

3. Rihapja e veprimtarisë bëhet përsëri me vendim të inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit, kur plotësohen kushtet e kërkuara.”.

Neni 13

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit ka të drejtë t’u heqë librezën shëndetësore personave që vuajnë ose janë bartës të mikrobeve të sëmundjeve ngjitëse, sipas ligjit për sëmundjet ngjitëse, për aq kohë sa këta të mos paraqesin rrezik si përhapës të infeksionit. Masa e heqjes së librezës, në varësi të rrethanave, mund të vlerësohet nga vetë inspektorati si masë urgjente ose dënim plotësues që jepet ndaj subjektit, të cilit i përkasin personat në fjalë.”.

Neni 14

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative. Gjjobat paguhen nga kundërvajtësi nëpërmjet sistemit bankar dhe derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 15

Nenet 3, 4, 6, 9, 14, 15, 17, 23, 24 dhe 34 shfuqizohen.

Neni 16

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8004, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 46/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 7975, DATË 26.7.1995 “PËR BARNAT
NARKOTIKE DHE LËNDËT PSIKOTROPE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 98, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB), si dhe organet e tjera të autorizuara bëjnë, të paktën një herë në dy vjet, inspektimin e programuar të objekteve, ndërtesave, lëndëve gjendje dhe regjistrave. Inspektimet jashtë programit kryhen në çdo kohë. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 99, fjalët “inspektorët e farmacisë” zëvendësohen me fjalët “inspektorët e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave (QKKB)”.

Neni 3

Në nenin 101 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Masa e gjobës është dënim kryesor.”.

Neni 4

Neni 102 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 102

1. Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Kundër vendimit të organeve të tjera që nuk gëzojnë statusin e inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
3. Ekzekutimi i vendimeve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 5
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8005, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 47/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9323, DATË 25.11.2004 “PËR
BARNAT DHE SHËRBIMIN FARMACEUTIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 31 shtohet pika 32 me këtë përmbajtje:

“32. “Inspektim” është çdo lloj forme kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, i cili bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 54, emërtimet “Inspektorati Veterinar” dhe “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohen, përkatësisht, me emërtimet “Shërbimi veterinar” dhe “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 3

Në nenin 57, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Masa e dënimit me gjobë është dënim kryesor, ndërsa masa e konfiskimit është dënim plotësues.”.



Neni 4

Neni 60 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 60

Marrja e vendimit dhe ankimi

1. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të marrë, sipas neneve 57, 58 e 59 të këtij ligji, bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Ekzekutimi i dënimeve me gjobë, sipas neneve të këtij ligji, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8006, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 48/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9518, DATË 18.4.2006 “PËR
MBROJTJEN E TË MITURVE NGA PËRDORIMI I ALKOOLIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Dënimi me gjobë është dënim kryesor.”.

Neni 2

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

1. Për zbatimin e nenit 11 pikat 1, 2, 3 dhe 4 ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.
2. Për zbatimin e nenit 11 pika 5 ngarkohet Policia Bashkiake.
3. Organet e kontrollit, sipas përcaktimit të këtij neni, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Ndaj vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.
5. Ndaj vendimit të Policisë Bashkiake mund të bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ekzekutimi i gjobave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8007, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 49/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9636, DATË 6.11.2006
“PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi “Policia Tatimore” zëvendësohet me emërtimin “Organet tatimore”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. “Mjedis publik” është çdo mjedis i hapur për publikun.”.

2. Në fund të pikës 13, fjalët “që frekuentohet gjatë orarit të punës” hiqen.

3. Pas pikës 17 shtohet pika 18 me këtë përmbajtje:

“18. “Mjedis i mbyllur” është:

a) një mjedis që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar plotësisht me mure të përhershme ose të përkohshme;

b) një mjedis, që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar me mure të përhershme ose të përkohshme, muret e të cilit kanë hapje të përhershme, që nuk mund të hapen apo të mbyllen, me sipërfaqe më pak se 50 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të mureve.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës “paralajmëuese” shtohen fjalët “në tekst dhe/ose në figurë”.

2. Në paragrafin e fundit, fjala “teksti” zëvendësohet me fjalën “përmbajtje”.

Neni 4

Në nenin 15, shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) Mjedise të tjera publike të mbyllura.”.

Neni 5

Në fund të nenit 16 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Forma dhe teksti i shenjave paralajmëuese përcaktohen nga KNMSHPD-ja.”.

Neni 6

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”.

2. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Organet e kontrollit, sipas përcaktimit të këtij neni, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.”.

Neni 7

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “c” dhe “ë” ndryshohen si më poshtë:

“c) shkelja e nenit 10 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë, sipas rastit, subjektit shitës me pakicë ose pronar i veprimtarisë së parashikuar;

ë) mospërmbushja e detyrimeve të parashikuara në nenet 15 dhe 16 nga pronari/administratori apo personi i caktuar përgjegjës prej tyre dënohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë për pronarin/administratorin e mjediseve apo personin e caktuar prej tyre.”.

2. Pas shkronjës “ë” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Masa e konfiskimit dhe asgjësimit janë dënime kryesore, ndërsa masa e gjobës është dënim kryesor kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues kur jepet njëkohësisht me masën e konfiskimit ose asgjësimit.”.

3. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Ankimi ndaj vendimeve të inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa ankimi ndaj organeve tatimore, doganore, Policisë Bashkiake ose të komunës bëhet sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8008, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 50/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9928, DATË 9.6.2008 “PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9928, datë 9.6.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 7, shkronja “b” shfuqizohet.



Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit

Mbikëqyrja për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në shërbimin shëndetësor stomatologjik, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobave është inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Masa e gjobës është dënim kryesor. Masa e ndërprerjes së veprimtarisë, sipas shkronjës “a” të këtij neni, është dënim plotësues dhe masa e mbylljes së veprimtarisë, sipas shkronjës “b” të këtij neni, është dënim kryesor.”.

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Ankimi

Ndaj vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8009, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 51/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 107, DATË 30.3.2009
“PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”.

Neni 2

Në nenin 23 pika 3, fjalët “dhe mbikëqyrjen e jashtme” hiqen.

Neni 3

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25
Inspektimi

Inspektimi i respektimit të kërkesave ligjore, të parashikuara në këtë ligj, i institucioneve të kujdesit shëndetësor kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Në nenin 26, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Institucionet shëndetësore i nënshtrohen procesit të akreditimit përmes Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësisimit nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara dhe të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë.”.

Neni 5

Në nenin 38 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) Shkelja e nenit 27 të këtij ligji nga personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, që ofrojnë kujdes shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, dënohet me gjobë 500 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me 5-fishin e gjobës dhe denoncim në organet kompetente.”.



2. Pas shkronjës “ç” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Masa e gjobës është dënim kryesor, ndërsa masa e heqjes së licencës është dënim plotësues.”.

Neni 6

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39
Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8010, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 52/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 138, DATË 11.5.2009 “PËR SHËNDETIN
PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Qëllimi dhe objekti

1. Inspektimi shëndetësor është çdo lloj forme kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, të vendosura nga legjislacioni në fuqi, për të ruajtur dhe përmirësuar shëndetin publik nga çdo subjekt, përfshirë institucione të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Inspektimi shëndetësor kryhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Struktura

1. Inspektimi shëndetësor kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, sipas fushave të veprimit që përcaktohen me ligje të veçanta.

2. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, për realizimin e detyrave, mbështetet teknikisht nga Instituti i Shëndetit Publik.”.

Neni 3

Në nenin 40, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Observatori Kombëtar Epidemiologjik dhe regjistrat kombëtarë të veçantë mbështeten nga Instituti i Shëndetit Publik.”.

Neni 4

Në nenin 43, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vlerësimi i ndikimit në shëndet realizohet nga struktura rajonale e shëndetit publik.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8011, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 11.3.2013
Doli nga shtypi më 12.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 49 lekë